

80 2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 701 Prot.

Tiranë, më 27.04 2015

Lënda: Dërgohet Vendimi nr. 114, datë 27.07.2015, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Drejtuar: - **Sekretar i Përgjithshëm**
Ministria e Arsimit dhe Sporteve

- **Erjona KACELI**

Tiranë


Të nderuar Zotërinj,

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin nr. 114, datë 27.07.2015 e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi ankesën nr. 23, datë 18.03.2015, e Znj. **Erjona Kaceli**.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Irma BARAKU

KOMISIONERI



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 114, Datë 27/10/2015

Pasi u njoh me ankesën nr. 23, datë 18.03.2015 të shtetases
Mbrojtjen nga Diskriminimi,

A, Komisioneri për

K O N S T A T O I :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 23, datë 18.03.2015, e Znj. Elona Leoni ku pretendohet për diskriminim për shkak të gjinisë, shtatëzanisë dhe gjendjes shëndetësore, nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesja është punësuar pranë Ministrisë së Arsimit, në pozicionin e specialistes, në janar të vitit 2010. Në fillim të vitit 2013 është promovuar duke u ngritur në detyrë në pozicionin “Përgjegjëse sektori”. Në datën 1 janar të vitit 2014, si pasojë e ristrukturimit të institucionit, ankuesja ka kaluar në listë pritjeje, për një afat një vjeçar. Gjatë këtij viti, ankuesja ka qenë shtatëzanë dhe si pasojë e gjendjes shëndetësore të saj dhe fëmijës së saj ende të palindur ka marrë dhe ka dorëzuar, periodikisht, disa raporte mjekësore pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, si më poshtë vijnë:

1. Në datën 23.12.2014 (me Nr. Protokolli: 3/2287 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit), ka dorëzuar pranë Institucionit raportin mjekësor për “**Partus Premature**” të qendrës shëndetësore Nr.5, me nr Regjistri 1294, datë **22.12.2014**, për të cilën i janë dhënë 7 (shtatë) ditë leje rregjim shtrati i detyruar.
2. Në datën 29.12.2014 (me Nr. Protokolli: 3/2354 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit), ka dorëzuar pranë Institucionit, raportin mjekësor për “**Partus Premature**” të qendrës shëndetësore Nr.5, me nr. Regjistri 1319, datë **29.12.2014**, për të cilën i janë dhënë 7 (shtatë) ditë leje rregjim shtrati i detyruar.

3. Në datën 06.01.2015 (me Nr. Protokolli: 3/8 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit), ka dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, raportin mjekësor për **"Partus Premature"** të qendrës shëndetësore Nr.5, me nr Regjistri 546, datë **05.01.2015**, për të cilën i janë dhënë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë leje rregjim shtrati i detyruar.

4. Në datën 20.01.2015 (me Nr. Protokolli: 3/203 të MAS), ka dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, raportin mjekësor për **"Leje Barrë lindje"** të qendrës shëndetësore Nr.5, me nr Regjistri 70, datë **20.01.2015**, për të cilën më janë dhënë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë leje paralindje.

Në datën 03.02.2015, ankuesja ka dërguar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me postë shkresën me lëndë: "Informacion mbi statusin e procedurës për marrjen e lejes së lindjes të Znj. [emri i ankueses], drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe për dijeni Ministrit të Arsimit dhe Sporteve. Njëkohësisht, në datën 05.02.2015, ankuesja ka dërguar sërish pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, raportin mjekësor "Leje Barrë lindje" të qendrës shëndetësore Nr.5, me nr. Regjistri 126, datë 04.02.2015, për të cilën i janë dhënë 20 (njëzetë) ditë leje paralindje. Në datën 26.02.2015, ankuesja i është drejtuar zyrtarisht përsëri Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, pasi nuk ka marrë përgjigje për sa më sipër. Ndërkohë, periudha 1-vjeçare e listës së pritjes për Znj. [emri i ankueses] ka përfunduar në datën 31 dhjetor 2014.

Në datën 01.03.2015, ankuesja ka lindur fëmijën e saj dhe ka përfituar raport mjekësor "Leje Lindje", me nr.2122780 Regjistri, Nr.0039815, datë 01.03.2015, për të cilin është vënë në dijeni Ministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm dhe Sektori i Burimeve Njerëzore.

Ankuesja pretendon se duke qenë se legjislacioni shqiptar e mbron gruan shtatzënë në marrëdhëniet e punës, duke mos lejuar në asnjë rast ndërprerjen e këtyre marrëdhënieve në mënyrë të njëanshme nga punëdhënësi gjatë shtatzënisë dhe sidomos gjatë raportit shëndetësor të barrë lindjes, lista e pritjes nuk mund të përfundonte, pa përfunduar më parë raportet mjekësore të barrë lindjes. Në këtë kontekst, ankuesja thekson faktin, se ligjërisht ajo duhet të ishte pjesë e listës së pritjes deri në muajin janar të vitit 2016, meqënëse periudha e qëndrimit në listë pritjeje shtyhet, për sa kohë që ajo ka qenë me raport mjekësor.

Për sa më sipër, ankuesja kërkon nga Komisioneri, si më poshtë vijon:

1. Konstatimin e diskriminimit të saj për shkak të gjinisë, shtatzënisë dhe gjendjes shëndetësore, nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
2. Ndërhyrjen e Komisionerit, në mënyrë që Ministria e Arsimit t'i kthejë një përgjigje zyrtare, të arsyetuar ligjërisht, mbi procedurën e ndjekur për lejen e paralindjes dhe lindjes.
3. Ndërhyrjen e Komisionerit, në mënyrë që MAS të ndjekë procedurat ligjore për plotësimin dhe dorëzimin e librezës së punës, referuar akteve ligjore në fuqi.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijnë :

1. Pas analizimit të ankesës nr. 23, datë 18.03.2015 të shtetase *[Emri i personit]*, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
2. Mbështetur në nenin¹ 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 265/1, datë 27.03.2015, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e ankueses *[Emri i personit]*.
 - Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, Ministria e Arsimit dhe Sportit dërgoi shkresën nr. 2561/1, datë 24.04.2015, ku jepen sqarimet përkatëse mbi çështjet e ngritura nga Znj. *[Emri i personit]*.

Referuar shkresës nr. 2561/1, datë 24.04.2015, Znj. *[Emri i personit]* ka qenë punonjëse civile pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Analizës së Politikave dhe Strategjive, në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve Ndërkombëtare. Në bazë të Urdhërit nr. 186, datë 18.10.2013, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, ky institucion hyri në procesin e ristrukturimit. Për shkak të suprimimit të vendit të punës dhe pamundësisë për ta sistemuar në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel, apo të një niveli më të ulët, në datën 31.12.2013, Znj. *[Emri i personit]* kaloi në listën e pritjes së nëpunësit civil. Duke filluar nga data 22.12.2014, pra vetëm 9 ditë para përfundimit të listës së pritjes, Znj. *[Emri i personit]* ka paraqitur me protokoll pranë MAS, raporte mjekësore për “**Partus Premature**”. Në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, parashikohet pagesa për një periudhë njëvjeçare e nëpunësit në listën e pritjes. Sipas MAS, gjatë periudhës së listës së pritjes, punonjësi nuk ka asnjë detyrim të paraqesë në institucion raporte mjekësore, pasi raporti justifikon një mungesë në punë, ndërsa gjatë listës së pritjes, nëpunësi nuk ushtron asnjë detyrë, thjesht paguhet për një vit.

Në këto kushte, KMD informohet mbi faktin se MAS iu drejtua Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civile dhe listës së pritjes. Deri në kthimin e përgjigjes së DAP, MAS nuk ka vepruar me plotësimin e librezës së punës së Znj. *[Emri i personit]*. Me shkresën nr. 931/1, datë 17.03.2015, DAP e vuri në dijeni Mas se rasti në fjalë duhet të zgjidhet nga vetë institucioni. Duke konsideruar faktin se Znj. *[Emri i personit]* ka paraqitur pranë MAS, raporte mjekësore gjatë periudhës që ishte në listën e pritjes së nëpunësit civil, me shkresën nr. 1775, datë 03.04.2015, MAS ka njoftuar Znj. *[Emri i personit]* për të tërhequr librezën e punës së mbyllur në datën 31.12.2014, të cilën e interesuara e ka marrë në dorëzim në datën 14.04.2015.

Ndër të tjera, MAS e bën me dije KMD-në, mbi faktin se nëse Znj. *[Emri i personit]* do të kishte paraqitur pranë këtij institucioni raportin për lejen e lindjes, Brenda afatit të listës së pritjes, MAS do të

¹Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

kishte ndërmarrë të gjithë hapat në respekt të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Në vijim të procedurave hetimore², në zbatim të Urdhërin nr. 54, datë 27.04.2015, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, për verifikimin e ankesës së Znj. *Tatjana Kaceli*”, inspektorët e KMD-së u paraqitën për inspektim pranë këtij institucioni.

Objekti i inspektimit konsistonte, si më poshtë vijon:

- Kryerja e verifikimeve, lidhur me procedurën e ndjekur nga strukturat përkatëse të MAS, mbi përfitimin e lejes së paralindjes dhe lejen e lindjes nga ana e Znj. *Tatjana Kaceli*.
- Informacion mbi zbatimin e procedurave përkatëse, lidhur me plotësimin e librezës së punës së Znj. *Tatjana Kaceli*.
- Informacion lidhur me faktin, nëse Znj. *Tatjana Kaceli* s’adodhet ende në listën e pritjes së MAS, si pasojë e ristrukturimit të këtij institucioni.
- Mbledhja dhe administrimi i informacioneve të tjera, që kanë lidhje me çështjen e Znj. *Tatjana Kaceli*.

Gjatë inspektimit, inspektorët e KMD-së u takuan me Znj. *Tatjana Kaceli*, specialiste pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në MAS. Meqënëse shkresa nr. 2561/1, datë 24.04.2015, e MAS, nuk kishte mbërritur ende pranë Komisioneri, Znj. *Tatjana Kaceli* sqaroi hollësisht lidhur me çështjen e Znj. Kaceli. Sipas saj, ankuesja kishte paraqitur pranë MAS, 9 ditë para përfundimit të listës së pritjes, raporte për lindje premature. Raportet për lindje premature nuk ishin marrë parasysh, pasi nuk kishin patur të bënin as me leje paralindjeje dhe as me leje lindjeje. Leja e paralindjes është dorëzuar nga ana e ankueses në datën 05.03.2015, pra pasi kishte përfunduar lista e pritjes. Znj. *Tatjana Kaceli* theksoi faktin se një rast i tillë nuk ishte ndeshur më parë, ndaj edhe nëpërmjet shkresës nr. 1775, datë 05.03.2015, MAS i është drejtuar DAP-it, ku i kërkohej se si duhej të vepronte për rastin konkret. Nëpërmjet shkresës nr. 931/1, datë 17.03.2015, Departamenti i Administratës Publike është përgjigjur se marrëdhënia financiare me punonjësin që është në listë pritjeje, menaxhohet nga vetë institucioni.

Sipas Znj. *Tatjana Kaceli* ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, (aktualisht i shfuqizuar) nuk ka patur parashikime konkrete për raste të tilla, por në nenin 1/3 të tij parashikohet se për ato çështje që nuk mbulohen nga ky ligj, do të zbatohet Kodi i Punës dhe legjislacioni përkatës.

Njëkohësisht, inspektorët u bënë me dije lidhur me faktin se librezja e Znj. *Tatjana Kaceli* është plotësuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe ankuesja e ka marrë në dorëzim në muajin prill 2015.

² Inspektimi u krye para mbërritjes së shkresës nr. 2561/1, datë 24.04.2015, të MAS pranë KMD-së.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

Znj. [emri i fshehtë] ka qenë punonjëse pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Analizës së Politikave dhe Strategjive, në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve Ndërkombëtare dhe gëzonte statusin e nëpunësit civil mbështetur në dispozitat përkatëse të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, i ndryshuar, i cili ka qenë ende në fuqi në atë kohë. Në bazë të Urdhërit nr. 186, datë 18.10.2013, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, ky institucion i është nënshtruar procesit të ristrukturimit. Për shkak të suprimimit të vendit të punës dhe pamundësisë për ta sistemuar në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel, apo të një niveli më të ulët, në datën **31.12.2013**, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, i ndryshuar, si dhe pikës³ 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 14.07.2000 “Për lirim nga shërbimi civil”, Znj. [emri i fshehtë] kaloi në listën e pritjes së nëpunësit civil. Referuar dispozitave të sipërpërmendura, lista e pritjes zgjati për një vit, pra deri në datën **31.12.2014**. Nëntë ditë para përfundimit të listës së pritjes, përkatësisht në datën **23.12.2014**, Znj. Kaceli ka paraqitur pranë MAS, një raport mjekësor për **“Partus Premature”** të qendrës shëndetësore Nr. 5, për të cilën i janë dhënë 7 (shtatë) ditë leje rregjim shtrati i detyruar. Ky raport është ndjekur nga 2 raporte të tjerë për **“Partus Premature”**, përkatësisht në datat **29.12.2014** dhe **06.01.2015**, për të cilët i janë dhënë 7 (shtatë) dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë leje rregjim shtrati i detyruar. Ndërkohë që, në datën **20.01.2015**, ankuesja ka dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, raportin mjekësor për **“Leje Barrë lindje”** të qendrës shëndetësore Nr.5, për të cilën i janë dhënë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë leje paralindje.

Sikurse u konstatua gjatë procesit të hetimit, MAS nuk i ka marrë parasysh raportet për **“Partus Premature”**, të dorëzuara nga ankuesja, (në mënyrë që lista e pritjes të fillonte të shtyhej duke filluar nga data **23.12.2014**), me arsyetimin se gjatë periudhës së listës së pritjes, punonjësi nuk ka asnjë detyrim të paraqesë në institucion raporte mjekësore, pasi raporti justifikon një mungesë në punë, ndërsa gjatë listës së pritjes, nëpunësi nuk ushtron asnjë detyrë, thjesht paguhet për një vit. Sipas MAS, nëse Znj. [emri i fshehtë] do të kishte paraqitur pranë këtij institucioni raportin për barrë lindje, brenda afatit të listës së pritjes, ky institucion do të kishte ndërmarrë të gjithë hapat në respekt të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në nenin 21, pika 1 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet: *“Personi i siguruar përfiton të ardhurat për sëmundje, kur vërtetohet me raport mjekësor se ai është përkohësisht i paafte për të punuar dhe kjo paafësi nuk është pasojë e një aksidenti në punë ose e një sëmundjeje profesionale”*.

³ Pika 7 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 14.07.2000 “Për lirim nga shërbimi civil” parashikonte: *“Nëpunësit e larguar, në kuadër të ristrukturimit të institucionit regjistrohen në një listë pritjeje, që mbahet nga Departamenti i Administratës Publike.....”*

Në nenin 26 të ligjit të mësipërm parashikohet :

“Në degën e sigurimit për barrë lindje paguhet:

- a) të ardhurat për barrë lindje;*
- b) të ardhurat për kompensimin për barrë lindje, kur ndryshohet vendi i punës;*
- c) shpërblimi për lindje fëmije”.*

Ndërkohë që në nenin 27, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet:

“1. E ardhura për barrë lindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përfshihet nga rregulli për periudhën e sigurimit rasti kur e drejta e pagesës për barrë lindjen e radhës ndodh brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm;

2. Periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 63 ditësh pas lindjes së fëmijës. Për gruan që do të ketë në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit do të jetë 390 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 60 ditë para dhe 63 ditë pas lindjes së fëmijëve”.

Sikurse rezulton nga sa me sipër, për sa kohë që nëpunësi është i siguruar, ai përfiton të ardhura përfiton të ardhurat për sëmundje, sikurse edhe të ardhura për barrë lindje.

Sikurse u përmend më lart, në këtë kohë ishte në fuqi dhe zbatohet ende ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, i ndryshuar, (tashmë i shfuqizuar). Në nenin 23, pika 2, këtij ligji parashikohet: *“Në rastet e ristrukturimit të institucioneve të administratës publike, nëpunësve civilë, vendet e të cilëve janë deklaruar të tepërt, do t’u ofrohet një vend i të njëjtit nivel në një ministri apo institucion tjetër të administratës publike qendrore dhe vendore ose në pamundësi, një vend i një niveli më të ulët. Nëpunësi civil vazhdon të gëzojë të drejtat e vendit të tij të mëparshëm, deri sa atij t’i ofrohet një vend tjetër, por jo më tepër se një vit.....”.*

Në interpretim të nenit të sipërpërmendur, rezulton se përgjatë 1 viti që nëpunësi është në listë pritjeje, vazhdon të gëzojë të drejtat e vendit të tij të mëparshëm të punës, por jo më tepër se 1 vit. Këtu, e vëmë theksin sidomos tek të drejtat me karakter financiar. Kështu, institucioni e paguan për 1 vit, nëpunësin në listë pritjeje, me pagën që i përket pozicionit të mëparshëm të punës, duke derdhur njëkohësisht edhe shumën përkatëse pranë ISSH-së në emër të punonjësit. Pra, nëpunësi që është në listë pritjeje, përgjatë një viti është i siguruar, sikurse çdo nëpunës tjetër. Pra, gjatë periudhës **31.12.2013 – 31.12.2014**, ankuesja ka gëzuar të gjitha të drejtat e pozicionit të saj të mëparshëm të punës, përfshirë këtu pajisjen me raport shëndetësor, sikurse çdo punonjës tjetër që është efektiv. Pra, në këtë kontekst gjykojmë që raportet mjekësore “partus premature” të dorëzuar nga ankuesja, duke filluar nga data 23.12.2014 e në vijim, duhet të ishin marrë

parasysh prej MAS, duke shtyrë edhe listën e pritjes për aq kohë sa kanë zgjatur keto raporte, si dhe raportet e barrë lindjes të depozituara në muajt vijues.

Nga verifikimet e kryera pranë MAS rezulton se nuk ka patur asnjëherë ndonjë rast analog me atë të Znj. Për zgjidhjen e kësaj situatë, MAS ka kërkuar edhe mendimin e Departamentit të Administratës Publike, institucion i cili është përgjigjur se *"marrëdhënia financiare me punonjës in që është në listë pritjeje, menaxhohet nga vetë institucioni"*, duke mos i dhënë drejtim kësaj çështjeje.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", parashikohet: *"Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim"*.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se Znj. , është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në krahasim me punonjës të tjerë të këtij institucioni. Ky trajtim, ka lidhje të drejtpërdrejtë, me gjendjen e saj shëndetësore dhe shtatëzaninë.

Në bazë të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka tagër për dhënie dëmshpërblimi moral (financiar), ndaj ankuesja duhet t'i drejtohet gjykatës, për të përfituar këtë dëmshpërblim.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2 3, pika 1, 4, pika 1, 7, pika 1, nenet 12, 13, 14 e 15, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si dhe ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të shtatëzanisë dhe gjendjes shëndetësore të Znj. nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

2. Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për shtyrjen e listës së pritjes për Znj. [Emri] për aq kohë sa janë dorëzuar raportet mjekësore, si dhe ndryshimet përkatëse të reflektohen në librezën e saj të punës.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Ministria e Arsimit dhe Sportit, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

